



# Skema Kos-GIRO




## Gjenerimi i faturave Kos-GIRO

Çdo kompani e cila rregullisht dërgon fatura, mund ta shfrytëzojë skemën Kos-GIRO. Për t'u bërë pjesë e kësaj skeme të pagesave, kompanitë faturuese duhet të ndryshojnë mënyrën e gjenerimit të faturës, si dhe të adoptojnë sistemin e tyre faturues për pranimin e dokumentit elektronik për barazim.

Apo në detaje:

- Ndryshimet në gjenerimin e faturës përfshijnë: gjenerimin e barkodit, gjenerimin e rreshtit të karaktereve OCR-B dhe ridizajnimin e faturës për të përfshirë në të edhe formularin standard të Kos-GIRO-s.
- Përshtatja e sistemit të faturuesit për pranimin e dokumentit elektronik për barazim do të mundësojë që procesi i freskimit të gjendjes së konsumatorëve të cilët kanë paguar përmes Kos-GIRO-s të bëhet çdo ditë.



## Kushtet e pagesës në bankë

Skema Kos-GIRO tanimë është implementuar në të gjitha bankat komerciale në Kosovë. Në këtë mënyrë konsumatorit i është ofruar mundësia e pagesës së faturave të shërbimeve publike përmes bankës. Për pagesat e kompanive private dhe shërbimeve publike.

Kjo mundësi i ofron konsumatorit komoditet në realizimin e pagesës së faturave të kompanive të ndryshme në të njëjtin vend, pra në bankë, si dhe shmangien e përdorimit të parasë së gatshme.


## Procesimi i pagesës në bankë

Përparësitë e procesimit të pagesave përmes skemës Kos-GIRO janë në kursimin e kohës së nevojitur për procesimin e pagesës dhe minimizimi i mundësisë së gabimit.

Teknologjia e barkodit dhe e rreshtit OCR-B ia mundëson bankave komerciale pranimin e pagesave në mënyrë automatike dhe bartjen e të dhënave përmes sistemit të sigurt bankar.

Banka e cila e zotëron xhirollogarinë e kompanisë faturuese do të gjenerojë dokumentin elektronik për barazim me detajet e pagesave sipas standardit të Kos-GIRO-s, dhe do t'ia dorëzojë atë kompanisë faturuese.

## Lexuesi i barkodit





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO




BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## Qëllimi i Skemës Kos-GIRO

Skema Kos-GIRO ka për qëllim rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së kryerjes së pagesave në Kosovë. Në këtë mënyrë do të zvogëlohet qarkullimi i parasë së gatshme jashtë bankave dhe do të rriten depozitat në banka, me ç'rast do të ndihmohet zhvillimi i ekonomisë së Kosovës.

Përparësitë e përdorimit të Skemës Kos-GIRO janë:

- Përmirësimi i kushteve për realizimin e pagesave të faturave përmes bankës.
- Automatizimi i procedurës së pranimit të pagesave në banka përmes teknologjive të reja.
- Gjenerimi i dokumentit për barazim nga banka për kompaninë faturuese.
- Barazimi automatik i faturave për pagesat e proceduara.



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.

Një ndër objektivat parësore të BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave.

Kos GIRO është skemë e pagesave që është zhvilluar në kuadër të SEKN-së, që mbikëqyret dhe rregullohet nga Drejtorati i Sistemeve të Pagesave Ndërbankare të BQK-së.


BQK-ja përmes kësaj skeme i lehtëson publikut kryerjen e pagesave, duke ua mundësuar atyre pagimin e faturave në bankë përmes transferimit të parave nga xhirollogaritë e tyre bankare.

Kjo mënyrë e pagesës mund të shfrytëzohet për faturuesit të cilët iu ofrojnë këtë mundësi konsumatorëve të tyre, dhe mund të bëhet në të gjitha bankat komerciale të cilat operojnë në Kosovë.

Adresa: Rr. Garibaldi Nr.33,  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 222 055

<http://www.bqk-kos.org>

E-mail: [payment.systems@bqk-kos.org](mailto:payment.systems@bqk-kos.org)



**Kos - GIRO**



Kos-GIRO është një skemë e pagesave që mundëson realizimin e pagesës së faturave përmes bankës. Është një ndër mënyrat më të volitshme për të paguar apo për të mbledhur pagesat. Përdorimi i tij kryesor është për pagesat periodike të rregullta, si: pagesat e regjistrimit, taksave ose faturat e shërbimeve publike.